

**VENDIM**  
**Nr.1375, datë 10.10.2008**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, MASTER I NIVELIT TË PARË NË MËSUESI, PËR CIKLIN E LARTË TË ARSIMIT BAZË, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME, NË UNIVERSITETIN “EQEREM ÇABEJ”, GJIROKASTËR, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në universitetin “Eqerem Çabej”, Gjirokastrë, në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, të programeve të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, si më poshtë vijon:

a) Në lëndët “Biologji-kimi”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët biologji-kimi;

b) Në lëndët “Matematikë-informatikë”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët matematikë-informatikë;

c) Në lëndët “Matematikë-fizikë”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët matematikë-fizikë;

ç) Në lëndën “Gjuhë angleze”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndën gjuhë angleze.

2. Programet e studimeve, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, realizohen me 60 kredite dhe zgjatja normale e tyre është një vit.

3. Kuota e pranimeve në programet e studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në universitetin “Eqerem Çabej”, Gjirokastrë, për vitin akademik 2008-2009, të jetë si më poshtë vijon:

a) Në lëndët biologji-kimi 40;

b) Në lëndët matematikë-informatikë 60;

c) Në lëndët matematikë-fizikë 60;

ç) Në lëndën gjuhë angleze 50.

4. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në vitin e parë, në këto programe studimi, në vitin akademik 2008-2009, të jetë sipas pikës 7/b të vendimit nr.1337, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë për programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë, si edhe tarifatat e shkollimit për programet e studimit, të miratuara për vitin akademik 2008-2009”.

5. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për universitetin “Eqerem Çabej”, Gjirokastrë.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Eqerem Çabej”, Gjirokastrë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**